Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera – Office of the Prime Minister

DEKLARATË E PERPUTHSHMERISE SË LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME ACQUIS TË BE-së

1. Organi propozues i aktit normativ:
Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim / Zyra e Kryeministrit

2. Titulli i projekt aktit normativ:
Projektligjin për ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare për IPA 2020 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian".

3. Përputhshmëria e aktit normativ me dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ose Marrëveshjes së Përkohshme:
Nuk aplikohet. Fushëveprimi i këtij Projektligji nuk kërkon transpozim apo harmonizim me acquis të BE-së.

3.1 Dispozitat e MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme në lidhje me përmbajtjen normative të aktit normativ:

Titulli IX Bashkëpunimi Financiar
Neni 121
Për të arritur objektivat e kësaj marrëveshjeje dhe në përputhje me nenet 7, 122 dhe 123 dhe 125 Kosova mund të marrë asistencë financiare nga BE-ja në formë grantesh dhe huash, duke përfshirë huat nga Banka Evropiane e Investimeve. Ndihma financiare e BE-se kushtëzohet me përparimin e mëtutjeshëm në përmbushjen e kritereve politike të Kopenhagës. Duhet, po ashtu, të merret në konsideratë përmbushja e detyrimeve të Kosovës me këtë marrëveshje si dhe raportet vjetore të progresit për Kosovën. Ndihma financiare e BE-së, po ashtu, do t'i nënshtrohet kushtëzimeve të PSA-së, në veçanti sa i përket angazhimit të përfituesit për të kryer reformat demokratike, ekonomike dhe institucionale. Ndihma financiare që i jepet Kosovës do të orientohet drejt nevojave të konstatuara, prioriteteve të pajtuara dhe kapacitetit për të thithur dhe për të dhënë rezultate si dhe masave të marra për të reformuar dhe për të ristrukturuar ekonominë.

Neni 122
Asistenca financiare, në formën grantesh, do të sigurohet në përputhje me rregulloret përkatëse të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit brenda një kornize indikative shumë-vjeçare të bazuar në programe vjetore apo shumëvjeçare të caktuara nga BE-ja pas konsultimeve me Kosovën.

Neni 123
Asistenca financiare mund të mbulojë të gjithë sektorët e bashkëpunimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, përafrimit të legjislacionit me acquis të BE-së, zhvillimit socio-ekonomik, qeverisjes së mirë, reformës së administratës publike, energjisë dhe bujqësisë.

Neni 124
Me kërkesë të Kosovës dhe në raste me nevoja të veçanta, BE-ja, në koordinim me institucionet ndërkombëtare financiare mund të shqyrtojë mundësinë e dhënies së asistencës makro-financiare në baza të jashtëzakonshme e cila varet nga kushte të caktuara, duke marrë parasysh disponueshmërinë e të gjitha burimeve financiare. Kjo asistencë mund të jepet pas përmbushjes së kushteve që do të vendosen në kontekstin e një programi për të cilin është arritur pajtimi në mes Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Neni 125
Me qëllim që të mundësohet përdorimi sa më optimal i burimeve ekzistuese, Palët do të sigurohen që asistenca financiare e BE-së të jepet në bashkëpunim të ngushtë me atë nga burimet e tjera si ato prej shteteve anëtare, vendeve të tjera jashtë BE-së dhe institucioneve financiare ndërkombëtare. Për këtë qëllim, Kosova duhet rregullisht të ofrojë informata për të gjitha burimet e asistencës.

3.2 Afati kohor i përcaktuar për përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit në përputhje me dispozitat e MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme:
Nuk aplikohet. Fushëveprimi i këtij Projektligji nuk kërkon transpozim apo harmonizim me acquis të BE-së.

3.3 Vlerësimi i nivelit të përmbushjes së detyrimit/obligimit që rrjedh nga dispozitat e lartpërmendura të MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme:
Nuk aplikohet. Fushëveprimi i këtij Projektligji nuk kërkon transpozim apo harmonizim me acquis të BE-së.

3.4 Arsyet për përmbushjen të pjesshme, ose mosplotësimi/dështimi për përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga dispozitat e lartpërmendura të MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme:
Nuk aplikohet. Fushëveprimi i këtij Projektligji nuk kërkon transpozim apo harmonizim me acquis të BE-së.

3.5 Ndërlidhja me Programin Kombëtar për Integrim PKI/ PKAA (në rastin aktual ndërlidhja me PKZMSA):
Kapitulli 22 i Acquis-së: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore. Masat në kuadër të këtij kapitulli janë të listuara në pjesën narative të programit të PKZMSA. Fushëveprimi i këtij Projektligji nuk kërkon transpozim apo harmonizim me acquis të BE-së.

4. Përputhshmëria e legjislacionit me Acquis e BE-së.
Nuk aplikohet. Fushëveprimi i këtij Projektligji nuk kërkon transpozim apo harmonizim me acquis të BE-së.

4.1 Lista e burimeve primare të së drejtës të BE-së dhe përputhshmëria.
Versioni i Konsoliduar i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, OJ C 326, 26.10.2012, p. 47–390.

Kreu 2
Bashkëpunimi ekonomik , financiar dhe teknik me vendet e treta
Neni 212
(ish-neni 181a TKE)
1. Pa cenuar dispozitat e tjera të Traktateve dhe në veçanti nenet nga 208 deri në 211, Bashkimi realizon masa të bashkëpunimit ekonomik, financiar dhe teknik, duke përfshirë mbështetje, në veçanti mbështetje financiare, me vendet e treta që nuk janë vende në zhvillim. Masa të tilla janë në pajtim me politikën e Bashkimit për zhvillim dhe zhvillohen në kuadër të parimeve dhe objektivave të veprimit të jashtëm të Bashkimit. Veprimet e Bashkimit dhe ato të Shteteve Anëtare plotësojnë dhe përforcojnë njëra-tjetrën.
2. Parlamenti Europian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative, miratojnë masat e nevojshme për zbatimin e paragrafit 1.
3. Brenda sferave përkatëse të kompetencës, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare

bashkëpunojnë me vendet e treta dhe me organizatat kompetente ndërkombëtare. Organizimi i bashkëpunimit të Bashkimit mund të jetë objekt i marrëveshjeve midis Bashkimit dhe palëve të treta të interesuara.
Nënparagrafi i parë nuk e cenon kompetencën e Shteteve Anëtare për të negociuar në organet ndërkombëtare dhe për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare.

4.2 Lista e burimeve sekondare të së drejtës të BE-së dhe përputhshmëria.
Rregullorja (EU) Nr 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 Mars 2014 për krijimin e Instrumentit për Asistencën të Para-Anëtarësimit (IPA II)
Rregullorja (EU) Nr 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 Marsit 2014 që përcakton rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e Instrumenteve të Bashkimit për Financimin e Veprimit të Jashtëm
Rregullorja (EU) Nr 447/2014 e 2 maj 2014 mbi rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) Nr. 231/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II)

4.3 Lista e burimeve tjera të së drejtës të BE dhe përputhshmëria.
Nuk aplikohet.

4.4 Arsyet për përputhje të pjesshme, apo mospërputhje.
Nuk aplikohet.

4.5 Periudha kohore brenda së cilës është e paraparë realizimi i plotë i perputhshmerisë të legjislacionit me Acquis e BE.
Nuk aplikohet.

5.Të specifikohet kur nuk ka legjislacion të BE-së me të cilën përputhshmëria është e kërkuar.
Fushëveprimi i këtij Projektligji nuk kërkon transpozim apo harmonizim me acquis të BE-së. Nuk aplikohet Tabela e përputhshmërisë së legjislacionit me acquis të BE-së.

6. A janë burimet e lartpërmendura të së drejtës së BE-së të përkthyera në gjuhët zyrtare.
Nuk aplikohet.

7. Pjesëmarrja e konsulentëve në hartimin e akteve normative dhe mendimin e tyre për përputhshmërinë (të bashkangjitur shkresat e konsulentëve për hartimin e akteve normative).
Nuk aplikohet.

8. Nënshkrimi i udhëheqësit të zyrës propozuese në kuadër të organit propozues të aktit normativ.

Florim Canolli, Drejtor i Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim / Zyra e Kryeministrit

Nënshkrimi, _____ dhe vula

9. Nënshkrimi i udhëheqësit më të lartë administrativ të organit propozues të aktit normativ.

Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm / Zyra e Kryeministrit

Nënshkrimi, _____ dhe vula